



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 7902 prot.

Himarë, më 21 . 10 . 2025

VENDIM

Nr. 48 , Datë 17/10/2025

**“PËR KORRIGJIMIN E GABIMIT MATERIAL NË ZBARDHJE TË VENDIMIT NR.
29, DATË 27.06.2025, TË KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË”**

Bazuar në nenin 112 të “Kodit të Procedurave Administrative”, ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, *i përditësuar*, administrata e Bashkisë Himarë, kryesisht, pasi konstatoi gabimin material në zbardhje, në titullin dhe në pikën “1”, të vendimit të Këshillit Bashkiak Himarë nr.29, datë 27.06.2025, “Mbi transferimin në pronësi të ujësjellës kanalizimeve Himarë sh.a., investimin me objekt ujësjellës kanalizimeve sh.a., të aseteve Ujësjellës Bolenë, Ujësjellës Kuç, Ujësjellës Kallarat që do të përdoren për ushtrimin e detyrave të saj funksionale në njësinë Horë-Vranisht”, me propozim të Drejtorisë Juridike dhe propozim të Kryetarit të Bashkisë: Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 17.10.2025, pasi shqyrtoi materialin e sjellë nga administrata e miratoi me 11 (njëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 5 (pesë) abstenim dhe si më poshtë:

VENDOSI:

1. Korrigjimin e gabimit në shkrim të titullit të vendimit të Këshillit Bashkiak Himarë nr.29, datë 27.06.2025, “Mbi transferimin në pronësi të ujësjellës kanalizimeve Himarë sh.a., investimin me objekt ujësjellës kanalizimeve sh.a., të aseteve Ujësjellës Bolenë, Ujësjellës Kuç, Ujësjellës Kallarat që do të përdoren për ushtrimin e detyrave të saj funksionale në njësinë Horë-Vranisht”, si më poshtë:

“Mbi transferimin në pronësi të aseteve Ujësjellësi Bolenë, Ujësjellësi Kuç, Ujësjellësi Kallarat, Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura në zonën bregdetare Dhrale- Palasë, Shoqërisë Rajonale Ujësjellës – Kanalizimeve Vlorë Sh.A.”

2. Korrigjimin e gabimit në shkrim të pikës “1” të vendimit të Këshillit Bashkiak Himarë nr.29, datë 27.06.2025, “Të miratohet transferimi kapital pa pagesë të aseteve në pronësi të Ujësjetllës Kanalizime sh.a., të aseteve Ujësjetllësi Bolenë, Ujësjetllësi Kuç, Ujësjetllësi Kallarat”, si më poshtë.

Pika 1 e vendimit Nr.29, datë 27.06.2025, korrigoheh në “Të miratohet transferimi kapital pa pagesë i aseteve në pronësi të Ujësjetllësi Bolenë, Ujësjetllësi Kuç, Ujësjetllësi Kallarat, Impianti i Trajtimis të Ujërave të Ndotura në zonën bregdetare Dhrate-Palasë, Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës – Kanalizimeve Vlorë Sh.A.”

3. Një kopje e këtij vendimi ti bashkohet vendimit nr.29, datë 27.06.2025, të Këshillit Bashkiak Himarë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit të Aseteve dhe Drejtoria e zhvillimit ekonomik.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë, bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 55 pika 6.

KRYETARI

Dhimitër Kapaj

